

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE**

**PROGRAMI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR**

**LËNDA: Edukim figurativ**

**(Klasa e pestë)**

**VITI SHKOLLOR 2008-2009**

**Tiranë, 2007**

## 1. TË PËRGJITHSHME

Programit i edukimit figurativ për klasën e pestë ka në qendër përvojën e nxënësit, të cilën e zbulon, e zhvillon dhe e pasuron duke e ndërthurur në mënyrë të natyrshme me historinë, kulturën, artin jo vetëm të qendrës ku jeton e mëson fëmija, por edhe me atë të krahinave të tjera të e të vendeve të ndryshme të botës. Ky program i jep mundësi nxënësit të përftojë njohuri dhe t'i interpretojë ato në mënyrë origjinale. Gjithashtu programi synon t'i aftësojë nxënësit për të krijuar dhe shprehur emocionet nëpërmjet artit figurativ.

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit do të nxjerrin në pah lidhjet e artit figurativ me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin ku zhvillohet. Lidhjet e artit me jetën do të pasqyrohen në punimet e nxënësit, i cili mund të krijojë pasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ etj.

## 2. SYNIME TË PËRGJITHSHME

Programi i edukimit figurativ ka për qëllim t'i ndihmojë nxënësit për të kuptuar artin figurativ dhe shprehur nëpërmjet tij. Ky program synon t'i pajis nxënësit me:

### **Njohuri:**

- për bazën materiale, proceset dhe teknikat, për përdorimin e tyre në përshtatje me këtë nivel moshor;
- të reja për elementet dhe parimet e artit duke i rimarrë disa prej tyre në një shkallë më të lartë vështirësie;
- për përdorimin dhe ndërthurjen e elementeve dhe parimeve të artit me linjat e tjera në mënyrë harmonike;
- për përdorimin e simboleve, tematikave të larmishme, bazës materiale e të teknikave të ndryshme në shërbim të idesë artistike;
- për historinë e artit në periudha të ndryshme.

### **Aftësi:**

- për vëzhgimin e elementeve e të parimeve të artit në natyrë dhe identifikimin e tyre në vepra arti, për të dalluar stile të artistëve të ndryshëm;
- për përshkrimin e punëve të veta apo shokëve dhe veprave të artistëve të ndryshëm në periudha të ndryshme;
- për të përzgjedhur elementet e parimet e artit në shërbim të temave të ndryshme;
- për zbatimin e njohurive të marra në këtë nivel në krijimtarinë e tyre artistike;
- për vlerësimin e punës së vet dhe të shokut/qes;

- për të bashkëpunuar dhe krijuar në grup, duke pranuar e duke respektuar kontributet dhe idetë e shokut/qes;
- për t'i përdorur njohuritë e marra në këtë lëndë në jetën e përditshme dhe në mjedisin ku jeton.

#### **Shkathtësi:**

- për përdorimin e bazës materiale dhe të teknikave në mënyrën dhe në kohën e duhur;
- për përdorimin e fjalorit artistik në përshtatje me këtë nivel;
- për përdorimin e komunikimit e mendimeve, të ideve, të emocioneve nëpërmjet temave të larmishme.

#### **Qëndrime:**

- për të formuar një qëndrim të pavarur në bazë të njohurive të marra;
- për të mbajtur qëndrim kritik ndaj një vepre arti;
- për të mbrojtur punën e tij dhe të marrë përgjegjësi;
- për të respektuar mendimin dhe punën e tjetrit.
- për të respektuar traditat, zakonet dhe kulturat e vendeve të tjera;
- për të rivlerësuar ato në lidhje me kohën;
- për të realizuar detyrat që i ngarkohen me seriozitet dhe përgjegjësi.

#### **Synimet e programit të edukimit figurative të klasës së pestë**

Programi i edukimit figurativ në klasën pestë ka për synim të ndihmojë në formimin artistik të nxënësit për të kuptuar artin figurativ dhe për t'u shprehur nëpërmjet tij.

Nëpërmjet këtij programi nxënësi/sja do të jetë i/e aftë:

- Të prodhojë punë me *dy e tre përmasa* që komunikojnë ide, mendime, ndjenja, përvoja, për qëllime të caktuara dhe për këtë nivel të caktuar, duke përdorur format e duhura të artit;
- Të krijojë punë të vetat, duke zbatuar *parimet e artit* (theksin, ritmin, baraspeshën, unitetin, lëvizjen, kontrastin, harmoninë);
- Të mbrojë punimin e tij/saj, duke u mbështetur në njohuritë e marra;
- Të krahasojë dhe komentojë vepra e artit sipas njohurive të marra në këtë nivel moshor;
- Të përdorë saktë *fjalorin dhe terminologjinë* e artit, në përshtatje me këtë nivel.

### **3. LINJAT E PËRMBAJTJES**

1. Baza materiale, procese, teknika
2. Parime dhe elemente
3. Tematika
4. Histori dhe kulturë
5. Analiza, interpretimi dhe vlerësimi
6. Lidhjet me jetën dhe mjedisin

#### 4. OBJEKTIVAT, NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE SIPAS LINJAVE. SHPËRNDARJA E ORËVE

Gjithsej	35 orë
Kurrikula zyrtare	32 orë
Kurrikula në dispozicion të mësuesit	3 orë

Linja	Objektivat	Konceptet dhe aftësitë kryesore	Numri i orëve sipas linjave
<b>Linja I.</b>  <b>Baza materiale, proceset, teknikat</b>	<p><b>Objektivat</b></p> <p>Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë mjetet: laps, vizore, penë (apo në kompjuter) duke realizuar një <i>shkrim me një stil</i> të caktuar. <ul style="list-style-type: none"> <li>- (Punë përgatitore mbledhja e disa stileve të shkrimit nga revistat, gazetat etj).</li> </ul> </li> <li>• Të përzgjedhë <i>mjetet</i> dhe <i>materialet</i> për të ilustruar një ngjarje personale. <ul style="list-style-type: none"> <li>- ( Punim me format 2 përmasore, p.sh. <i>kolazh</i> ).</li> </ul> </li> <li>• Të dallojë vepra arti të periudhave të ndryshme historike, duke kuptuar dhe u bazuar në <i>mjetet</i> dhe <i>teknikat e përdorura</i> për krijimin e tyre si: pikturat e shpellave, skulpturën në gur, mermer etj., enët e qeramikës, pikturat murale, pikturat në papirus etj. <ul style="list-style-type: none"> <li>- (Bisedë e ilustruar me libra ose foto të gjetura në internet).</li> </ul> </li> </ul>	akuareli stampimi vizatimi me laps dhe shkumësa modele me plastelinë gdhendja me sapun kolazhi përdorimi i penelit dhënia e linjave krijimi i stampave me gdhendje ndërthurja e materialeve në teknikën e kolazhit përdorimi i lapsit, vizores, penës	<b>4 orë</b>

<p><b>Linja II.</b></p> <p><b>Elemente dhe parime</b></p>	<p><b>Objektivat</b></p> <p>Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë <i>vijat</i> për të krijuar perspektivën me një pikë ikje. - (Shinat e trenit).</li> <li>• Të përdorë <i>lloje të ndryshme formash (figurat)</i> për të krijuar imazhe vizuale. - (Pejsazh ose natyrë e qetë, duke e realizuar me lapustilë).</li> <li>• Të përdorë <i>formën tre përmasore</i> për të krijuar objekte funksionale. - - (Krijon forma funksionale në rolin e një artist dizajni si: enë kuzhine, mobilie, makinë etj. – plastelinë, baltë etj.)</li> <li>• Të krijojë <i>sipërfaqen</i> nga përdorimi i materialeve të ndryshme.</li> <li>• Të përdorë tre materiale të ndryshme për të krijuar një punë 2 ose 3 përmasore, dhe të përcaktojë ndryshimin e sipërfaqeve). - (Instalacion me tre materiale të ndryshme).</li> <li>• Të përdorë <i>kontraste të ndryshme ngjyrash</i>, për të krijuar një gjendje emocionale. - (Përdorimi i tonaliteteve të përafërta me kontraste të buta, tregon një gjendje qetësie, ndërsa kontrastet e forta të ngjyrave parësore dhe dytësore krijojnë një gjendje hareje).</li> <li>• Të përdorë <i>hapësirën</i> për të identifikuar <i>qendrën e interesit</i> ose <i>pikën e theksit</i>. Përdorimi i perspektivës me dy pika ikje, konceptim i</li> </ul>	<p>hapësirë</p> <p>sipërfaqe</p> <p>formë</p> <p>imazh</p> <p>peizazh</p> <p>natyrë e qetë</p> <p>qendër interesi</p> <p>unitet</p> <p>baraspeshë simetrike dhe asimetrike, përmasë</p> <p>kontrast ngjyrash</p> <p>ngjyra parësore</p> <p>ngjyra dytësore</p>	<p><b>12 orë</b></p>
-----------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------

	<p>thjeshtë për të dhënë idenë e tre përmasores në krijimin 2 përmasor. - - (Qyteti nënujor)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë <i>baraspeshën simetrike ose asimetrike</i> për të krijuar një poster për ndonjë aktivitet shkollor. (Tema mund të merret nga lënda e Edukatës shoqërore).</li> <li>• Të përdorë <i>masën, ngjyrën, formën</i> për të krijuar <i>qendrën e interesit</i>. - - (Dekoracion duke përdorur masën, ngjyrat, formën).</li> <li>• Të krijojë një punë ku jepet ideja e lëvizjes, duke përsëritur elementët e <i>vijave, ngjyrave dhe formave</i>. - (Ditëlindja ime).</li> <li>• Të krijojë përmes elementit të <i>unitetit</i>, duke përsëritur elementët. (Ky objektivi mund të realizohet në një temë mësimore me atë të lëvizjes).</li> <li>• Të krijojë <i>kontrastin</i> në krijim, duke përdorur një nga elementet: <i>vijën, formën, ose ngjyrën</i> për të tërhequr vëmendjen e shikuesit. - (Një njoftim ose reklamë etj.).</li> </ul>		
<b>Linja III. Tematika</b>	<p><b>Objektivat</b></p> <p>Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përzgjedhë <i>bazën materiale dhe teknikën e duhur</i>, si dhe <i>elementet e parimet e artit</i> në shërbim të përmbajtjes. - (Krijimi i një albumi familjar, ku nxënësi/sja dekoron pjesën e kapakut).</li> <li>• Të diskutojë <i>figurat simbolike</i> të një seti letrash – lojë dhe ti krijojë</li> </ul>	<p>figurat simbolike</p> <p>simbole</p> <p>album</p>	<b>3 orë</b>

	ato në grup. - (Lojë ( letra bixhozi - punë në grup).		
<b>Linja IV.</b>  <b>Historia dhe kultura</b>	<b>Objektivat</b>  Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojë që <i>flora, fauna, ngjyrat e natyrës</i> ndikojnë në krijimtarinë artistike të një artisti/steje. Njohja me kulturën popullore shqiptare si: <i>dekoracionet, veshjet, objektet artistike</i> etj. - (Kopjim i një motivi popullor).</li> <li>• Të flasë për artistët e artit figurativ shqiptar dhe të përshkruajë veprimtarinë e tyre artistike si: (V. Miho, A. Buza etj).</li> <li>• Të përshkruajë ndikimin e materialeve në krijimin e një arti të veçantë: arti i sixhadeve.</li> </ul>	fauna  ngjyra natyre  dekoracion  veshje  objekt artistik  material	<b>4 orë</b>
<b>Linja V.</b>  <b>Analiza, interpretimi dhe vlerësimi</b>	<b>Objektivat</b>  Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shpjegojë përdorimin e <i>kontrastit, theksit dhe perspektivës</i> në vepra të ndryshme arti ose në punën e tij/saj dhe të shokut/qes.</li> <li>• Të bashkëpunojë në krijimin e një ekspozite punimesh në shkollë. - (Bisedë me një kurator në një ekspozitë, në një shkollë apo në një galeri arti).</li> </ul>	kontrasti  theksi  perspektiva  ekspozitë  galeri  bashkëpunimi	<b>4 orë</b>



<p><b>Linja VI.</b></p> <p><b>Lidhja ndërlëndore me jetën dhe mjedisin</b></p>	<p><b>Objektivat</b></p> <p>Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të komentojë marrëdhëniet e artit në jetën e përditshme si: dekorimi i mjediseve familjare apo në klasë, në raste festash. - (Zbukurimi i klasës me rastin e Vitit të Ri, 7 -8 Marsit).</li> <li>• Të përshkruajë arkitekturën e qendrës së banimit, si është dhe si mund të ishte ndryshe. - (Krijim me objekte 3 përmasore, duke përdorur trupa gjeometrikë të gatshëm).</li> <li>• Të kuptojë artin e mobilimit të shtëpisë. - (Krijim-moket me karton e një hapësire të brendshme).</li> </ul>	<p>dekorimi</p> <p>mobilie</p> <p>mobilitim</p> <p>arkitekturë</p> <p>moket</p>	<p><b>5 orë</b></p>
--------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------	---------------------

### **Kurrikula e lirë**

Kurrikula e lirë (deri në 15% e sasisë totale të orëve) është lënë në dispozicion të mësuesit. Statusi i saj është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të mësuesit në bashkëpunim me drejtorinë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Qëllimi i kurrikulës së lirë është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për realizimin e saj mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve, të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

*Organizimi i ekskursioneve apo vizitave në qendra të ndryshme kulturore si në galeri arti, muzeume, kala, ndërtesa karakteristike apo shtëpi muze etj., janë veprimtari praktike të pasuara me detyra të cilat janë në shërbim të një objekti të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës për një linjë; organizimi i ekspozitave, biseda dhe diskutime me artistë të ndryshëm.* Përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxëniet ashtu edhe mësuesin, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për realizimin e efektshëm të kurrikulës së lirë mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërlëndore dhe u shërben arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të të kurrikulës së lirë

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

## **6. INTEGRIMI**

Programi i edukimit figurativ jep mundësinë që në tema të shumta të zhvillohet integrimi i njohurive dhe aftësive me ato të lëndëve të tjera. Përmes këtij integrimi nxënësit mësojnë të studiojnë konceptet jo vetëm në një lëndë por në disa, brenda fushës dhe jashtë saj. Kështu në matematikë njihen me format në kuptimin matematik. Gjithashtu në këtë lëndë përmes studimit të formës, ngjyrës etj., nxënësi/sja mëson të lidhë krijimin e tij/saj me *dekoracione të ndryshme* që ai i mëson edhe në histori. **Pra** nxënësit mësojnë të ndërtojnë lidhjet ndërmjet edukimit figurativ dhe matematikës, historisë, diturisë së natyrës, edukatës qytetare dhe gjeografisë, duke gjetur të përbashkëtat dhe duke kuptuar që ato mund të përdoren në fusha të ndryshme ku ata përgatiten.

**Integrimi** në linjën e “Elementeve dhe parimeve” mund të bëhet me: me matematikën format dhe trupat gjeometrikë - *Figurat e rregullta e të çrregullta gjeometrike*. Ose edhe me lëndën e aftësimin teknologjik.

**Integrimi** në linjën e “Tematikës” bëhet me edukatën shoqërore, e parë kjo nga tema në të cilën do të përcaktojë mësuesi për realizimin e objektivave dhe njohurive.

**Integrimi** në linjën e “Historia dhe kultura”, bëhet me lëndën e historisë, gjeografisë, diturinë e natyrës.

Gjithashtu integrimi do të bëhet edhe përmes ndërthurjes së koncepteve bazë të lëndëve me njëra tjetrën, të metodologjive si dhe me shkencat më të përafërta.

**Aspektet kros-kurrikulare** janë pasur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

## **7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT**

Zbatimi me sukses i programit kërkon përgatitje dhe përgjegjësi nga përdoruesit të cilët duhet të drejtojnë e të nxisin veprimtarinë e nxënësit. Përdoruesit duhet të njohin shumë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jenë vazhdimisht të interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale apo të drejtuar nga institucionet përgjegjëse, të krijojnë një bazë të domosdoshme materiale për t’i paraprirë një zhvillimi normal të orës së mësimi, të sqarojnë më parë të gjitha çështjet e paqarta të përmbajtjes, që mos të jetë në dilemë për atë që do t’i transmetojnë nxënësit. Tek zbrëthimi i secilës linjë janë dhënë niveli i përvetësimit të koncepteve, teknikat, aftësitë, shprehitë si dhe tema të mundshme për hartimin e planit konkret.

Plani mësimor mund të ndërtohet në 6 rubrika: 1) Tematika; 2) Tema për çdo orë mësimi; 3) Nënlinjat; 4) Mjetet; 5) Teknikat dhe 6) Shënime për detyrat a problemet që dalin.

Për zbatimin me sukses të programit në përgatitjen ditore të parashikohet dhe veprimtaria në grup e të gjithë nxënësve dhe për nxënësit me probleme, sidomos detyra të veçanta të parashikohen për nxënësit e talentuar. Njëkohësisht është e domosdoshme që për të pasur rendiment në

zbatimin e programit, të vendosen lidhje me artistë të zonës ku jetojnë nxënësit, të realizohen veprimtari, si: ekspozita me një tematikë të caktuar, biseda, vizita në studiot e piktorëve etj. Nga realizimi me sukses apo jo i orës së mësimit bëhet nxitja ose frenimin i interesave të nxënësit për artin.

Karakteristikë e rëndësishme në këtë klasë, si në të gjithë programin, është *liria individuale në krijim*, e cila do të thotë që nxënësi/sja duhet të zbatojë njohuritë e marra nga programi, duke ia përshtatur stilit të tij/saj të punës dhe fantazisë së vet.

Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi mësues-nxënës gjatë procesit mësimor të mbështetet edhe në përvojën e nxënësit/es.

### **Mjetet dhe përdorimi i tyre**

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të një veprimi të tillë, mund këshillohet për të përdorur mjetet në grup.

#### *Grupi i parë:*

-shkumësa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

#### *Grupi i dytë:*

-vinovil, letër ngjitëse, skoç, vizore, gërshërë.

#### *Grupi i tretë:*

-penela të ndryshme, të cilat janë të përcaktuara në paketa të veçanta (penelat të jenë të disa madhësive), fletore vizatimi, fletore punëdore, letër tabak, kartonë me ngjyra, letër për të shkruar A4.

#### *Grupi i katërt:*

-mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempere, akuarele.

#### *Grupi i pestë:*

-mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

### **Vendi i punës**

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurativ, është shumë e rëndësishme që nxënësi/sja duhet të punojë me një dritë të plotë, me një vend të sigurt ku t'i mbështes mjetet e tij/saj, në një vend të ngrohët e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa studio. Në pamundësi të sigurimit të studios, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

### **8. VLERËSIMI**

Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në standardet e arritjes, një dokument të cilin çdo përdorues/e duhet ta ketë gjithmonë pranë, për të qenë sa më i qartë e i saktë në veprimtarinë e përditshme mësimore. Metodologjia për të vlerësuar nxënësit nuk do të bazohet në konkurrencë, por në bazë të një diskutimi të natyrshëm për arritjet dhe ato që nxënësi/sja duhet të realizojë më mirë. Në diskutim të marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi/sja në bazë të objektivave të orës së mësimit.

Ky diskutim zakonisht bëhet në fund të orës së mësimit. Në vlerësim do të merret parasysh dhe vetëvlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut/qes.

Nxënësi/sja **vlerësohet me notë:**

- për pjesëmarrjen në procesin krijues, për përdorimin e teknikave të përdorura, për përdorimin e mjeteve dhe materialeve në mënyrë efektive, për zbatimin e njohurive në krijimet e tyre, për lidhjen e artit me realitetin, për analizat dhe vlerësimet që bën, për bashkëpunimin dhe punën në grup.

Vlerësimi me notë bëhet me grup -tema për të gjithë nxënësit apo dhe në mënyrë individuale sipas kriterëve që mund të vendosë shkolla.